



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 328/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Ashkalinve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj, për shkak të mashtrimit të opinionit nëpërmjet facebookut para fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

HIDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalinve të Kosovës (PAI), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më dt. 23.10.2013, nga subjekti politik PAI, me të cilën pretendohet se Qazim Rrahmani nëpërmjet facebookut ka publikuar kinse është bartës i listës, me të cilin publikim, ka mashtruar opinionin e gjerë para fushatës zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi .

PZAP-i shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës dhe gjeti se :

ankesa është e pa lejuar

Pretendimet ankimore se anëtari i PDAK-së Qazim Rrahmani anëtar i PDAK-së para fushatës zgjedhore ka postuar në facebook se është bartës i listës votuese duke mashtruar opinionin, PZAP-i, nuk i shqyrtoi pretendimet ankimore sepse fillimi i fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore nuk është në kompetencë të PZAP-it dhe si e tillë nuk është e sanksionuar me LZP e as me rregulla zgjedhore, andaj ne kuptim te dispozitës së nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv te këtij vendimi .

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 328/13 më datën 25.10.2013



Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.